

VENDIM
Nr. 145, datë 13.2.2020

**PËR KUSHTET, RREGULLAT DHE DOKUMENTET QË SHOQËROJNË
KËRKESËN PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR RINDËRTIMIN,
RIPARIMIN APO RESTAURIMIN E NDËRTIMEVE TË DESTINUARA PËR
QËLLIME BANIMI, TË DËMTUARA SI PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE,
PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TAKSËS SË NDIKIMIT NË
INFRASTRUKTURË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e kushteve, rregullave dhe dokumenteve që shoqërojnë kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2. Për të përfituar përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas pikës 9, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, për investimet që shërbejnë për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, së bashku me dokumentacionin përkatës që shoqëron kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit, investitori duhet të paraqesë edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

- a) aktin që vërteton dëmtimin e ndërtesës për shkak të fatkeqësisë natyrore;
- b) dokumentin që përcakton shkallën e dëmtimit të ndërtesës, vlerën në lekë të dëmtimit, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe nivelin e ndërhyrjes që nevojitet në ndërtesën e dëmtuar.

Dokumentet e mësipërme lëshohen nga autoriteti përkatës, të përcaktuara sipas procedurave të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”, që bëjnë vlerësimin e dëmeve në rastin e fatkeqësisë natyrore.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore verifikojnë dokumentet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, dhe, në rast të plotësimit të tyre, aplikojnë përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama